



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1710/ 11 prot.

Datë 31 .07.2026

VENDIM
Nr.901 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.847/2026, datë 22.06.2026 për procedurën e prokurimit, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k, me NIPT L01606034A dhe adresë: *Rruga “e Dibrës”*

Operatori ekonomik “REXHA-CO” sh.p.k, me Nipt M02430008M dhe adresë: *Unaza e Re, Rruga Mikel Maruli, Pallati Pienvis, Shkalla 2, Dyqani Nr.4 , Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës, me adresë: *Lagja nr.1, Rruga Tregtare, Durrës.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.847 /2026, ku vendosi:

- 1.Të mbyllë çështjen për ankesën e pranuar të operatorit ekonomik “REXHA-CO” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
- 2.Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK,për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
- 3.Autoriteti Kontraktor te rivlersoje proceduren e prokurimit publik sipas konsatimeve te ketij vendimi, dhe vendimit të KSHA.*
- 4.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5.Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REXHA-CO” SHPK.*
- 6.Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.*
- 7.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2322 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1710/8 prot., date 01.07.2026, autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit duke rivlersuar procedurën e prokurimit objekt ankimi si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2322 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1710/8 prot., date 01.07.2026, autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit duke rivlersuar procedurën e prokurimit objekt ankimi si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II.2. Për sa më sipër, Komisioni pas verifikimeve të sistemit elektronik, konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka zbatuar vendimin Nr. 847/2026, datë 22.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84434-05-06-2026, me objekt “Blerje Barrierash”, me fond limit 9,889,667 (Nëntë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 19-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini